



POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

- 1
- 2
- 3
- 4
- 5
- Lajthitë mbeten stok në Fier e Mallakastër, fermerët: Prodhimi është i bollshëm, por

Kronikë

Arrestohet 'si nëpër filma', 32-vjeçari rrethohet nga policia në Tiranë dhe nxirret nga makina në 5 sekonda! I gjendet pistoletë pa leje dhe 15 800 euro (EMRI+VIDEO)

Pamjet e ndërhyrjes tregojnë momentin kur efektivët i bllokojnë rrugën, e rrethojnë automjetin dhe e nxjerrin drejtuesin brenda pak sekondash.

32-vjeçari rrethohet nga policia dhe nxirret nga makina! I gjendet pistoletë pa leje dhe 15 800 euro (EMRI+VIDEO)

Report TV



Watch on

Redaksia 23 Gusht, 12:06 | Përditësimi: 23 Gusht, 12:34

Share Post WhatsApp



Një skenë që ngjante me ato të filmave aksion u regjistrua në **Tiranë**, ku dy efektivë të Policisë rrethuan një automjet dhe nxorën menjëherë drejtuesin e tij, gjatë operacionit të koduar “Last Gun”.

Sipas Policisë, në pranga u vu 32 vjeçari Renato Vuka i cili dyshohej se qarkullonte i armatosur me një automjet tip “Citroen DS3”. Ai u lokalizua dhe u ndalua në rrugën “Collakët”, ku gjatë kontrollit në automjet u gjet dhe u sekuestrua një armë zjarri **pistoletë** me municion.

Në cilësinë e provës materiale, policia sekuestroi gjithashtu automjetin, dy aparate celularë dhe 15 800 euro.



LEXO EDHE:
Arrestohet në Milano reperi italian, Tony Boy del në transmetim ‘live’ kur policia i hyn në shtëpi! Efektivët gjejnë drogë e armë (VIDEO)

Ai akuzohet për veprën penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyeshe dhe i municionit”.

Njoftimi i plotë i Policisë së Shtetit

Finalizohet me sukses operacioni policor i koduar “LAST GUN”. Qarkullonte me automjet, i armatosur me pistoletë, kapet në flagrancë dhe vihet në pranga 32-vjeçari. Sekuestrohen 1 armë zjarri pistoletë, municion, 1 automjet, 2 aparate celularë dhe 15 800 euro. Në vijim të punës për goditjen e rasteve të armëmbajtjes pa leje, shërbimet e Komisarariatit të Policisë Nr. 1, bazuar në informacionet e siguruara në rrugë operative se një shtetas qarkullonte me automjet dhe dyshohej se mbante armë zjarri, organizuan dhe finalizuan operacionin “Last Gun”. Në kuadër të cilit në rrugën “Collakët”, shërbimet e Policisë lokalizuan dhe ndaluan automjetin tip “Citroen DS3”, me të cilin qarkullonte shtetasi R. V., 32 vjeç. Gjatë kontrollit të automjetit, iu gjet dhe sekuestrua një armë zjarri pistoletë së bashku me municion. Gjithashtu, në cilësinë e provës materiale u sekuestruan automjeti, 2 aparate celularë dhe shuma prej 15 800 eurosh. Në përfundim të veprimeve procedurale, shtetasi R. V. u arrestua në flagrancë për veprën penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyeshe dhe i municionit”. Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë për veprime të mëtejshme.

Sqarim: Çdo person prezumohet i pafajshëm deri sa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë

U.D/Shqiptarja.com

TAG: Tiranë armëmbajtje pa leje pistoletë

Sa e vlerësoni këtë artikull? 3.0 / 5 (2 vlerësime)

LAJMET MË TË VLERËSUARA

Komente

Komento

Glaj: 23/08/2026 14:38

Nga i nxorret sekondat?!

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016




Sondazhi i ditës:
Si po menaxhohet situata me zjarret?

23 Gusht, 08:55

Mirë Keq Nuk e di

Lajme të tjera




Dhuno i shqiptar dhe kërcënoi të shoqen me pistoletë, arrestohet në Palasë 'Visi i Garave!' Arma gjendet e fshehur te tubat e ujit (VIDEO)

23 Gusht, 15:04



Kapen 5.2 kg kokainë e heroinë në Tiranë, arrestohen 2 persona! Droga do trafikohet drejt Durrësit

23 Gusht, 14:41



Ishte në arrest shtëpie, por dilte për të vjedhur në Tiranë, arrestohet 23-vjeçarit që boshatisi kasat e 5 bizneseve në kryeqytet (VIDEO)


23 Gusht, 11:18



Fatos Çoçoli: Do rinizet protesta në shtator?

Fatos Çoçoli

22 Gusht, 19:12




Ministri Nufi viziton te ‘Trauma’ ushtarin e plagosur gjatë operacionit për shuarjen e flakëve në Mirditë, Report Tv siguron pamjet (VIDEO)

22 Gusht, 18:17



Hoxha takon drejtuesit e institucioneve në Luginën e Preshevës: Të drejtat e shqiptarëve, prioritet i yni

22 Gusht, 16:53




Delegacioni i Global Sumud Flotilla në Vlorë, Ministria e Turizmit u ‘zë pritë’: Erdhën për të shpëtuar Sazanin, por nuk shkuan në ishull! Rama: Revolucionarët e rrenave i ikin të vërtetës si djalli temianit (VIDEO)

22 Gusht, 15:44



Me pistoletë në makinë, arrestohet 40-vjeçari në Tiranë (VIDEO)

22 Gusht, 13:47



Tiranë/ 41-vjeçarit i vendoset lëndë plasëse në makinë, policia nis hetimet

22 Gusht, 13:00



Superliga zhvillon sot dy ndeshjet e radhës, Bratu përpara Partizani - Teuta: E njoh trajnerin rival, objektivi titullin dhe Kupa

22 Gusht, 10:36



Karakaçi: Shqipëria përmbushi detyrimet në fushën e energjisë! Priten 61 mln euro nga Plani i Rritjes i BE

21 Gusht, 17:22



'Llogaraja'/ U tejkaluan afatet, Gentian Gjyli dhe Erald Elezi dalin nga arresti shtëpiak! Gjykata cakton masën detyrim paraqitjeje

21 Gusht, 12:17

Lajmi i fundit



Krisa në Kosovë/ PDK nuk heq dorë, i dërgon sërish letër Deharit: Të hënën në 11:00 deputetët do të jenë në sallë

23 Gusht, 22:54



×

[Sh]

.com

Lajmi i fundit



Kriza në Kosovë/ PDK nuk heq dorë, i dërgon sërish letër Deharit: Të hënën në 11:00 deputetët do të jenë në sallë

23 Gusht, 22:54